

DRAFT DOKUMENT

Mësimi tërëditor në Prishtinë

27 Gusht 2015

Përmbajtja:

Qëllimi:.....	1
Shkollat:	2
Përgatitjet 2015:	3
Programi:	4
Kalendari:	10
Organizatrat bashkëpunuese:	11

Qëllimi:

Nxënësit e shkollave publike në Kosovë kalojnë më pak se 20 orë në shkollë. Kjo është pak krahasuar me vendet e tjera Evropiane, ku nxënësit i kalojnë deri në 40 orë duke mësuar në shkollë. Kjo ngaqë nuk ka mjaft hapësira shkollore për të gjithë nxënësit, sidomos nëpër zonat urbane, në mënyrë që të gjithë të qëndrojnë në shkollë gjatë tërë ditës. Si rezultat, nxënësit e Kosovës kanë më pak mundësi të zhvillojnë aftësitë dhe dituritë e bashkëmohatarëve të tyre në rajon e Bashkim Evropian.

Se sa kanë mbetur prapa nxënësit në Kosovë do ta mësojmë në vitin 2016 kur edhe do t'i shohim rezultatet e testit ndërkombëtar PISA¹, në të cilin Kosova mori pjesë për herë të parë në vitin 2015. Ndërsa sipas testeve që i ka administruar Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me klasët e pesta, arritshmëria në lëndët bazike ka qenë shumë e ulët: rreth 30 përqind në matematikë dhe rreth 50 përqind në gjuhë shqipe. Këta nxënës pastaj kanë vështirësi të mëdha në nxënie kur të kalojnë në shkollën e mesme të ulët, ku ballafaqohen me më shumë lëndë dhe ku kërkohet zotërim më i mirë i aftësive bazike në gjuhë (të shprehur, të shkruar, të lexuar dhe komunikim i përgjithshëm) dhe matematikë (duke përfshirë edhe mendimin logjik).

Komuna e Prishtinës synon ta ndryshoj këtë gjendje. Ne do ta implementojmë mësimin tërëditor duke filluar në shtator 2015 në disa shkolla të Prishtinës. Implementimi do të jetë gradual, me faza tranzitore që lejojnë shkollat të adaptohen me orarin e ri, dhe mësimdhënësit të përgaditen për pjesën shtesë mësimore.

Mësimi tërëditor i adreson një numër sfidash arsimore dhe krijon mundësinë për rritjen e kualitetit në arsim, duke:

¹ Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve (PISA) vlerëson 15 vjeçarët nga mbi 60 vende të botës në aftësitë bazike Gjuhë, Matematikë dhe Shkenca: <https://kk.rks-gov.net/fushekosove/FusheKosove/media/Dokumente/Fletepalosja-e-konferences.pdf>
Kosova merr pjesë për herë të parë dhe rezultatet nuk janë publikuar ende. Por nga viti 2012, nga 65 vendet, Shqipëria kishte marrë vendin e 57-të, ndërsa Serbia vendin e 43-të - të dy vendet nën mesataren.

- **zbutur efektin që gjendja socio-ekonomike e nxënësve ka në nxënie.** Fëmijët që vijnë nga familjet e varfëra apo me prindër të pashkolluar, nuk kanë kushte të mira për mësim, nuk kanë libra në shtëpi apo edhe nuk marrin vëmendje me detyra të shtëpisë, rrjedhimisht ngecin në mësim dhe rezultatet e tyre në shkollë dallojnë me nxënësit që vijnë nga familjet që qëndrojnë më mirë financiarisht (të cilët shpesh edhe i dërgojnë fëmijët e tyre nëpër kurse private ku marrin mësim shitesë vetëm e vetëm sepse kanë mundësi të paguajnë). Mësimi tërëditor e adreson këtë problem duke i mbajtur në shkollë dhe të ekspozuar ndaj mësimit dhe librave, të gjithë fëmijët pa marrë parasysh kushtet ekonomike në shtëpi, dhe duke i adresuar në mënyrë më të individualizuar nxënësit me ngecje në mësim.
- **përmirësuar arritshmërinë e nxënësve në aftësi bazike:** gjuhë dhe komunikim (kulturë e të folurit, shkruarit, lexuarit) dhe matematikë (logjikë)
- **identifikuar ngeçjet në mësim** dhe adresuar ato gjatë pjesës së shtuar të orarit
- **identifikuar interesimet dhe shkathtësitë** e nxënësve në fusha të ndryshme dhe organizuar aktivitete që zhvillojnë tutje ato shkathtësi
- **përmirësuar shëndetin** e nxënësve përmes orëve të shtuara të edukatës fizike, organizimit të skuadrave në sporte të caktuara, dhe këshillave të qarta për ushqimin që fëmijët mund ta marrin me vete në shkollë
- **përmirësuar kulturën dhe dituritë** e përgjithshme të nxënësve

Shkollat:

Për vitin 2015-2016 kemi përzgjedhur **tri shkolla** ku do ta implementojmë mësimin tërëditor.

Shkolla “**Model**”, Prishtinë, 660 nxënës

Shkolla “**Afrim Gashi**”, Hajvali, 635 nxënës

Shkolla “**Faik Konica**”, Prishtinë, 1,298 nxënës, *por vetëm rreth 350 nxënës – përkatësisht klasët e treta dhe të gjashta - do të mbajnë mësimin tërëditor*

Këto shkolla përfaqësojnë disa nga llojet e shkollave në Prishtinë:

shkollat e ngarkuara urbane me 800 - 1,500 nxënës që punojnë me dy ndërrime,

shkollat periferike apo rurale me 100 - 800 nxënës që punojnë me një ndërrim dhe

shkolla “Model” që përfaqëson vizionin e komunës së Prishtinës për të gjitha shkollat në të ardhmën.

Në komunën e Prishtinës ka edhe shkolla me më pak se 100 nxënës apo më shumë se 1,500 nxënës, të cilat do të përfshihen në mësimin tërëditor në fazat e mëvonshme të zhvillimit të projektit.

Prej shkollave të përzgjedhura për sivjet, më sfiduesja do të jetë shkolla “Faik Konica” e cila punon me dy ndërrime dhe ka pak hapësira të lira. Por duke marrë parasysh që kjo shkollë është duke e pilotuar Kornizën e Re Kurrikulare² që kërkon mësim tërëditor, aty do të imlementojmë metoda kreative të shfrytëzimit të hapësirave shkollore, në kombinim me vizita të organizuara jashtë shkollës.

Përgatitjet 2015:

Prej janarit të vitit 2015, zyrtarë të Komunës së Prishtinës kanë mbajtur takime me prindër, mësimdhënës dhe udhëheqës të shkollave, për ta diskutuar projektin e mësimin tërëditor. Takimet janë intensifikuar në muajt maj dhe qershor, kur kemi mbajtur katër takime të përbashkëta me drejtorët e tri shkollave, si dhe nga një takim në secilën shkollë me Këshillat drejtues të shkollave, mësimdhënës dhe prindër. Gjithashtu, kemi mbajtur një takim shtesë me kolektivin e Shfmu “Faik Konica” dhe përfaqësuesit e prindërve të kësaj shkolle.

Përmes këtyre takimeve kemi mësuar më shumë për sfidat dhe mundësitë që ka secila shkollë, për mbarëvajtjen e procesit të mësimin tërëditor. Ju bëjmë ftesë të gjithë lexuesve të këtij dokumenti, që:

- a) të përcjellni tutje dokumentin te palët e interesuara, dhe
- b) të dërgoni vërejtjet dhe sygjerimet tuaja për sfidat dhe mundësinë e tejkalimit të tyre.

Afati i fundit për t'i dërguar vërejtjet dhe komentet tuaja është 15 shtator 2015.

Mësimi tërëditor, si dhe çdo intervenim tjetër në arsim, i prekë dhe u përket të gjithë qytetarëve të Prishtinës, kështu që ju ftojme të bëheni pjesë e saj duke na shkruar në këtë e-mail: ardiana.ismaili@rks-gov.net

Dreka:

Një çështje e veçantë që është ngritur nëpër takimet me mësimdhënës dhe prindër ka qenë çështja e drekës dhe nëse Komuna e Prishtinës do të ofrojë ushqime të nxehta për nxënësit në mësimin tërëditor. E kemi shqyrtuar mundësinë për këtë çështje dhe kemi konkluduar që kjo nuk do të jetë e mundshme për dy vitet e ardhshme shkollore, dhe do ta rishqyrtojmë prapë si çështje në të ardhmëm.

Kjo, ngase shkollat nuk kanë hapësira të mjaftueshme të cilat mund të shfrytëzohen si dhoma ushqimi dhe Komuna nuk ka mjete financiare për ta siguruar këtë. Gjithashtu, aktivitetet shtesë dhe mësimi plotësues do ta zgjatë ditën e nxënësve në shkollë për pak orë (shihni orarin më poshtë), kohë e përbalueshme për nxënësit tanë edhe pa drekë të nxehtë.

Por ajo që do të bëjmë është përforcimi i programit të kifleve edhe me një pije qumështi për të gjithë nxënësit e klasëve 1-5. Ndërsa për nxënësit e tjerë që marrin pjesë në projektin e mësimin tërëditor do të kërkojmë që të sjellin ushqim nga shtëpia.

²

Për më shumë shihni KKK: http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Korniza_e_kurrikules11.pdf

Dreka do të jetë 30 minuta kështu që nxënësit do të kenë kohë edhe të dalin të blejnë drekën e tyre. Por ky nuk është sygjërimi jonë sepse mendojmë që në të shumtën e rasteve, ushqimi i shpejtë që blehet nga dyqanet përreth është më pak i ushqyeshëm dhe më e kushtueshme se sa shujta që mund të përgatitet në shtëpi. Nga eksperiencia në vendet e tjera ku mbahet mësimi tërëditor, llojet e drekave që sjellin nxënësit me vete përfshijnë kombinime të ushqimeve të thata por të shëndetshme, frutave që nuk kërkojnë qëndrim në frigorifer, ujë dhe/apo lëngje frutash.

Për shembull:

Një sendviq me djath dhe tranguj
(trangulli mund të zëvendësohet me perime tjera, me vezë të ziera, me pulë apo tuna)
Një mollë apo banane apo karrotë

Të bashkangjitur me këtë dokument mund ta gjeni një listë sugjerimesh për dreka të lehta që marrin më pak se 10 minuta të përgatiten, nuk janë të kushtueshme, dhe përmajnë mjaft vlera ushqyese që të mbajnë nxënësit të vëmendshëm gjatë orëve shtesë.

Nëse keni ju sugjerime për dreka të lehta na shkruani në e-mail: Ardiana.ismaili@rks-gov.net që ta përditësojmë listën e recetave dhe ta ndajmë me prindërit dhe kujdestarët e nxënësve.

Për nxënësit që vijnë nga familjet me të ardhura shumë të ulëta (deri në 130 Euro në muaj) apo në asistencë sociale, do të krijojmë fond subvencioni që tu mundësojmë edhe atyre dreka të ushqyeshme.

Programi:

Orët shtesë tek mësimi tërëditor do të mbahen pas përfundimit të mësimit të rregullt. Pra nxënësit mbajnë mësim me orar të rregullt dhe të njejtat lëndë si në krejt shkollat e tjera deri në kohën e drekës. Pas drekës fillojmë me programin e mësimit tërëditor.

Një shembull ilustrues i orarit të mësimit mund të duket kështu:

8.00 - 8.30	Ardhja në shkollë
8.30 - 12.30	Mësimi i rregullt
12.30 - 13.00	Dreka
13.00 - 15.00	Programi i mësimit tërëditor
15.00 - 15.30	Shkuarja në shtëpi

Ora e nisjes dhe mbarimit ndryshon prej shkollës në shkollë si dhe prej klasës në klasë, ku klasët e dyta, për shembull, e përfundojnë mësimin më herët se klasët e teta.

Fokusi i programit do të jetë në dy fusha:

1. lexim-shkrim/kuptueshmëri (fusha e gjuhëve dhe komunikimit), dhe
2. edukatë fizike.

Kjo ndërlihet me vizionin e Komunës së Prishtinës për arsimin në komunë, që synon ta **përmirësoj arritshmërinë e nxënësve në gjuhën e parë**, duke përmirësuar të folurit, të shkruarit dhe komunikimin si dhe të ju ndihmojë nxënësve të kenë një **trup të shëndoshë** përmes aktiviteteve fizike.

Përtej kësaj do të organizojmë mësim plotësues për nxënësit me neçje në mësim si dhe aktivitete zgjedhore. Por duhet të ceket se programi do të zhvillohet gradualisht, duke shtuar orët nga muaji në muaj dhe duke i testuar ndryshimet që do të ndërmerren nëpër shkolla.

Për nxënësit më të vegjël do të ketë më pak orë shtesë ndërsa për shkollën e mesme të ulët më shumë.

Për ilustrim, orari mund të duket kështu:

Mbani mend: kjo nuk vlen për muajt e parë të vitit shkollor 2015/2016 – për më shumë shihni kalendarin e aktiviteteve më poshtë.

Per klasët 1-3 dhe klasët 4-5

Gjysëmvjetori I: Lexim, Mësim Plotësues, Sport

Gjysëmvjetori II: Lexim, Mësim Plotësues, Sport, *Aktivitete Zgjedhore*

Klasët 1-3 (Gjysëmvjetori I)

	Hëne	Marte	Mërkure	Enjte	Premte
45 min	Lexim	Sport	Lexim	Sport	Lexim

Klasët 1-3 (Gjysëmvjetori II)

	Hëne	Marte	Mërkure	Enjte	Premte
45 min	Lexim	Sport	Lexim	Sport	Aktivitet

Klasët 4-5 (Gjysëmvjetori I)

	Hëne	Marte	Mërkure	Enjte	Premte
45 min	Lexim	Lexim	Lexim	Lexim	Lexim
45 min	m. plotësues	Sport	m.plotësues	Sport	m.plotësues

Klasët 4-5 (Gjysëmvjetori II)

	Hane	Marte	Merkure	Ejte	Premte
45 min	Lexim	Lexim	Lexim	Lexim	Aktivitet
45 min	m.plotësues	Sport	Sport	m.plotësues	Aktivitet

Për klasët 6-9:

Gjysëmvjetori I dhe II: Lexim, Mësim Plotësues, Sport, *Aktivitete Zgjedhore*

Klasët 6-9 (Gjysëmvjetori I)

	Hëne	Marte	Mërkure	Enjte	Premte
45 min	Lexim	Lexim	Lexim	Lexim	Lexim
45 min	m.plotësues	Sport	m.plotësues	Sport	m.plotësues
45 min	Aktivitet	Aktivitet	Aktivitet	Aktivitet	Aktivitet

Klasët 6-9 (Gjysëmvjetori II)

	Hëne	Marte	Mërkure	Enjte	Premte
45 min	Lexim	Lexim	Lexim	Lexim	Lexim
45 min	m.plotësues	Sport	m.plotësues	Sport	m.plotësues
45 min	Aktivitet	Aktivitet	Aktivitet	Aktivitet	Aktivitet

Leximi:

Lexim shkrimi është aftësi bazike. Ajo i duhet secilit njeri që ta kuptojë dhe të merr pjesë suksesshëm në botën që e rrethon. Për fat të keq kemi shumë nxënës në Kosovë që i kanë aftësitë e dobëta në lexim-shkrim, që rrjedhimisht i pamundëson atyre të marrin pjesë aktive në jetën shkollore por edhe ngadalëson zhvillimin e tyre në të rritur të punësueshëm, të lumtur dhe qytetar aktivë.

Një studim i BE-së për shkrim-leximin (2012)³ përmban tri definicione të lexim-shkrimit:

Lexim-shkrimi i shumëfishët: përdorimi i aftësisë së leximit dhe shkrimit për të prodhuar, interpretuar dhe vlerësuar tekste komplekse (niveli 3 e më lartë në PISA)

Lexim-shkrimi funksional: mundësia për të lexuar dhe shkruar në nivel që mundëson funksionimin në shoqëri, shtëpi, shkollë dhe punë (niveli 2 në PISA).

Lexim-shkrimi bazik: mundësia për të lexuar e shkruar mjaftueshëm sa për ta pasur vetëbesimin që mund të zhvillohet aftësia tutje (niveli 1 në PISA).⁴

Pasi që lexim-shkrimi është aftësi bazike që mundëson shkollimin e mëtutjeshëm, ai duhet të adresohet herët në fëmijëri që mos të ketë ngecje në mësim.

Sipas studimit të BE-së:

“Njerëzit me aftësi të dobëta të shkrim leximit janë të prirur të mos e përfundojnë shkollën, të mbesin të papunë...dhe të vuajnë nga shëndeti i dobët.”⁵

³ EU High Level Group of Experts on Literacy (EU HLGEL), Final Report 2012, http://ec.europa.eu/education/policy/school/doc/literacy-report_en.pdf

⁴ EU HLGEL, Final Report, p.13

⁵ EU HLGEL, Final Report, p.21

“Shkrim leximi i dobët e pengon arsimimin e mëtutjeshëm, punësimin por edhe dobëson aspiratat dhe ambicjet e njerëzve”⁶

“Vendet e punës janë duke kërkuar aftësi më të avancuara të shkrim leximit, çdo ditë e më shumë. Industritë që zhvillohen sot kërkojnë dituri dhe inovacion nga të gjithë punëtorët, edhe ata që kryejn punët më bazike...për shembull, vozitësit e autobusëve dhe mirëmbajtësit e banesave duhet të jenë në gjendje të lexojnë dhe shkruajn raporte të incidenteve, duke përdorur kompjuterin.”⁷

Në Kosovë, këto lloj punësh ende nuk kërkojnë keso lloj aftësish, por do të kërkojnë në të ardhmën. Nëpër universitete në Kosovë, profesorët ankohen që studentët ju vijnë analfabet funksional, të cilët nuk dijnë shkrim bazik dhe kanë vështirësi të përfitojnë nga studimet në universitet.

Për të qenë aktiv në shoqëri, për t’u kujdesur për familjen duke qenë në gjendje të kuptojnë sigurimet sociale, shëndetësore, aplikacionet për pasaporta etj, si dhe për tu angazhuar politikisht për një shoqëri demokratike, shkrim leximi i avansuar mbetet qenësor.

Si arrihet kjo:

Sipas të njejtit studim, fëmijët që rriten në shtëpi ku ka shumë libra kanë aftësi më të mira të shkrim leximit. Pra leximi i shtuar e përmirëson shkrimin, leximin, kuptueshmërinë. Ndërsa aktivitetet ku diskutohet për leximin në grup, përmirësojnë edhe të folurit edhe të dëgjuarit.

Për klasët 1-3: do të punohet me programin A-EGRA⁸, të disejnuar, testuar dhe implementuar në Kosovë nga Basic Education Program (BEP) që ka arritur të rritë kuptueshmërinë e teksteve tek nxënësit më të vegjël. Instrumenti A-EGRA do të administrohet për t’i identifikuar nxënësit që kanë vështirësitë më të mëdha në lexim, dhe për këtë grup do të implementohet strategji e veçantë në përmirësimin e shkathtësive të leximit.

Përveç leximit të obliguar ku titujt e librave do të përzgjidhen paraprakisht, nxënësit do të vizitojnë bibliotekat e qytetit apo bibliotekën shkollore që të përzgjedhin edhe librat të tjerë, për të cilat ata kanë interesim. Për nxënësit më të vegjël, mësimdhënësit do të aplikojnë metoda të lehta për tu ndihmuar nxënësve të përzgjedhin librin e përshtatshëm për nivelin e tyre të leximit: për shembull, nxënësi e lexon një paragraph me 50 fjalë dhe nëse i bën 2-3 gabime ai libër konsiderohet i përshtatshëm ndërsa nëse i bën më shumë se 5 gabime ai libër ruhet për tu lexuar më vonë, pas përmirësimit të aftësive të leximit.

Për klasët 4-5 dhe 6-9: do të identifikohen tituj të përshtatshëm për moshën, por jashtë listës së lektyrave shkollore, që do të përdoren nga mësimdhënësit për ta zhvilluar orën e leximit. Këta libra do të dërgohen nëpër shkolla përmes programit të furnizimit të librave nëpër bibliotekat shkollore: Prishtina Lexon.

⁶ EU HLGEL, Final Report, p.21

⁷ EU HLGEL, Final Report, p.24

⁸ Për më shumë informata rreth programit A-EGRA, ju lutem shihni:

<https://www.dropbox.com/sh/bdjlvdxfndyk8im/AABD4FpKyLoJ4uBD6XESMM6Wa/Albanian-EGRA.pdf?dl=0>

Përveç librave do të identifikohen artikuj dhe forma tjera të shkruara që do të lexohen dhe do të punohet me to. Këto duhet të jenë të përshtatshme për moshën dhe në përputhshmëri me planprogramet e gjuhës shqipe (por edhe historisë, edukatës qytetare etj).⁹

Do të përdoren metoda mirë të hulumtuara për stimulim të leximit. Nxënësit do të ekspozohen ndaj një game më të gjërë të librave fikcion dhe jo fikcion, nga literatura botërore e përkthyer dhe ajo vendore e përzgjedhur. Ata pastaj do ti përdorin ato si modele për shkrimet e veta.

Do të fokusohet vëmendja në:

mësimin e fjalëve të reja të gjuhës shqipe,
në identifikimin e fjalëve të fuqishme apo interesante,
në identifikimin e fjalive efektive që përçojnë kuptimin lehtësisht
në drejtshkrimin dhe përmirësimin e të shkruarit

Një numër prej 50 apo 100 fjalë të reja do të identifikohen bashkë me nxënësit dhe do të shkruhen e vendosen në mur (ato edhe mund të zgjedhohen apo vendosen nëpër fjali!). Në këtë mënyrë sigurohet memorizimi i tyre dhe pasurimi i fjalorit të të gjithë klasës e jo vetëm i nxënësve që i kanë identifikuar ato fjalë gjatë leximit të librave të tyre.

Në disa orë të leximit do të ketë vetëm lexim ndërsa në disa të tjera 30 min lexim e 15 minuta diskutim të fjalëve të reja, interesante etj.

Disa orë të leximit do të përdoren për shkrim, prezantim apo diskutim të asaj që është lexuar.

Nxënësit duhet ta kenë me vete edhe një libër që e zgjedhin vet dhe e lexojnë për qejf – në rastet kur koncentrimi është i ulët apo në orët e leximit të lirë të lexohet libri i preferuar.

Në fund të vitit programi **do të testohet dhe krahasohet** me një grup kontrollues (shkolla të ngjashme që nuk kanë kaluar nëpër program) që të shihet impakti i orëve të shtuara të leximit tek nxënësit.

Përzgjedhja e librave dhe puna me mësimdhënësit e gjuhës dhe ata klasor, do të bëhet gjatë shtatorit 2015 për të filluar me programin e leximit në tetor 2015.

Sporti/Edukata Fizike

Aktiviteti fizik është themelor, sepse është pararojë për lëndët e tjera, përgatitja fizike është shumë e lidhur me suksesin e të rinjve në shkollë.

Sporti ka një ndikim shumë të rëndësishëm në mirërritjen dhe shëndetin e fëmijëve. Luan një rol të rëndësishëm duke ndikuar në edukimin e tyre fizik dhe mendor. Çdo sport ka karakteristika të veçanta që duhen marrë në konsideratë, sidomos kur bëhet fjalë për fëmijët e vegjël në kopsht apo shkollë fillore, një moshë delikate për rritjen fizike dhe psikologjike.

⁹ Për planprogramet e gjuhës shqipe shihni websajtin e MASHT, ndërsa këtu mund të gjeni udhërrëfyesin për implementimin e kurrikulës së re në gjuhët dhe komunikimin: http://www.ipk-rks.net/publikime_me_shume.php?publikimet_id=44

Fëmijët kanë nevojë çdo ditë për aktivitet fizik sidomos në ditët e sotme që lojërat e zakonshme fizike janë zëvendësuar nga ato elektronike që ndikojnë negativisht në shtimin e peshës tek fëmijët etj. Sporti gjithashtu nxit vetëvlerësimin tek fëmijët, u jep atyre një ndjenjë kënaqësie kjo kur i shtohet edhe mbështetja nga prindërit.

Sporti ka ndikim e tij dhe në aspekte të tjera të rëndësishme si:

- Rrit socializimin mes fëmijëve dhe punën në grup
- Argëton fëmijët
- Zhvillon aftësitë e menaxhimit të kohës
- I mëson të vendosë objektiva
- I mëson si të përballen me problemet

Përfitimet: lista e përfitimeve të lëvizjes gjatë adoleshencës është e gjatë: një studim australian, i bërë në një kampion prej 2300 vetash të moshës 13 vjeç ka treguar se të praktikosh sportin përmirëson aspektin psikologjik dhe cilësinë e jetës së të rinjve; një studim i publikuar në “Journal of Adolescent Health” ka treguar se mjaftojnë tri javë ushtrime fizike të rregullta (30 minuta vrap në mëngjes tri herë në javë) për të përmirësuar cilësinë e gjumit dhe performancën shkollore të 18-vjeçarëve. Ndërsa një tjetër studim amerikan ka treguar se aktiviteti i rregullt sportiv redukton agresivitetin tek adoleshentët.

Ushtrimet e rregullta përmirësojnë aktivitetin neuromuskulor dhe kapacitetin aerobik, ndjenjën e mirëqenies dhe kapacitetin për të përballuar stresin. Për më tepër nuk duhen nënvlerësuar edhe pasojat sociale: të rinjtë që nuk merren me sport, kur përfshihen në një aktivitet fizik në grup, e ndiejnë veten në vështirësi, me rrezikun për ta ndjerë veten të mënjanuar. Kjo çon në krijimin e një rrethi vicioz (sedentarizëm dhe rritje në peshë), nga cila është e vështirë të dalësh.

Sipas orarit të mësimi tërëditor në 3 shkolla të Prishtinës do të jenë 2 orë shtesë në javë sport, duke e marrë parasysh numrin e orëve atëherë është e mundur që brenda vitit të aplikohen shumë lloje të sportit dhe ushtrime të përgjithshme kardio dhe muskulore.

Gjatë muajit shtator, arsimtarët e edukatës fizike, mësuesit klasor dhe profesorë të edukatës fizike, do të punojnë së bashku që të krijojnë programin e sportit/edukatës fizike të përshtatshme për moshat e ndryshme dhe të aplikueshme në tri shkollat.

Mësimi Plotësues:

Rezultatet nga testimi që MASHT-i bëri me klasët e pesta në Prishtinë, doli që nxënësit tanë kanë përvetësuar vetëm 30 përqind të matematikës së nevojshme për të vazhduar shkollimin e mëtutjeshëm. Por në të njejtën kohë, kemi në Prishtinë nxënës që janë të shkëlqyeshëm në matematikë, por edhe shkenca, të cilët me vetëdëshirë dhe vetëorganizim kanë arritur të mësojnë më shumë se moshatarët e tyre në shkencat natyrore.

Mësimi tërëditor do të adresojë këto dy grupe, duke identifikuar nxënësit që kanë më së shumti nevojë për ndihme dhe atyre t’u ipet mësim plotësues, si dhe klubet e shkencës për ata që kanë nevojë për mësim shtesë.

Identifikimi i nevojave do të bëhet gjatë muajit shtator kur edhe do të ndahen grupet e nxënësve dhe do të zhvillohet programi për mësimin plotësues dhe shtesë (klubet).

Aktivitetet Zgjedhore:

(varen nga hapësira e shkollës dhe stafi – nuk do të thotë të jenë të njëjta në të gjitha shkollat)

Skuadra Sporti: futboll, basketboll

Shkenca: eksperimente (kimi, fizikë, biologji) që reflektojnë punën e bërë gjatë javës. Programi Qasja Fillestare në Eksperiment (QFE) është i përshtatshëm dhe mund të zhvillohet me paisje të thjeshta. Disa mësime të shkencave janë të familjarizuara me këtë. Për të tjerët do të organizojmë trajnime që ata të mund t'a implementojnë këtë program gjatë mësimit tërëditor.

Matematikë: Algjebër e Avancuar, Matematikë për Kodim

Artet: Kinematografi/Dramë/Pikturë/Muzikë

Gjuhët: Anglisht, Gjermanisht

Aktivitetet e tjera:

Vizitat në natyrë

Galeri arti

Muze

Projekte të pavarura (hulumtime, vizita në bibliotekë, eksperimente etj – punë 1 javore gjatë gjithë orarit 2 në mars)

Kalendari:Gusht 2015: java 3 dhe 4

Takime me 3 shkollat: mësime të mësimit dhe prindërit

Identifikimi i 3 kordinatorëve të jashtëm që do të vendosen nëpër shkollat pasditeve

Të krijohen grupet punuese në secilën shkollë

Kordinatori/ja

Drejtori/ja apo zëvendësit

Mësime të mësimit përkatës që do ta organizojnë/mbikëqyrin projektin

Shtator 2015: java 1, 2, 3 dhe 4

Takime ditore të secilit grup punues prej orës 13:00 – 16:00 që të:

Identifikohen nxënësit që kanë nevojë për mësime plotësues në lëndë të ndryshme

Organizohen mësime të mësimit për ta ofruar këtë mësime

Krijohet programi i leximit dhe sportit

Gjatë **shtatorit do të mbajmë edhe takimet me prindërit** nëpër tri shkollat ku do të zhvillohet mësimi tërëditor. Me prindër do të diskutohet programi dhe do të planifikohen disa aktivitete të përbashkëta. Gjithashtu, do të shohim mundësinë që prindërit të involvohen më shumë në pjesën përmbajtësore të shkollimit të fëmijëve të tyre, duke mbajtur ligjerata në shkollë për tema në të cilat ata kanë ekspertizë, apo edhe forma tjera.

Tetor 2015: java 1

Fillon programi tërëditor. Orari i fillimit të programit mund të shtyhet nëse shkollat nuk janë përgatitur me 1 tetor.

Organizatrat bashkëpunuese:

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), <http://www.masht-gov.net/>

Fakulteti i Edukimit, <http://edukimi.uni-pr.edu/>

Fakulteti i Shkencave Sportive, <http://fshs.uni-pr.edu/>

Kosovo Basic Education Program (BEP), <http://bep-ks.org/>

Capacity Development on Basic Education (CDBE), <http://www.cdbe.info/>

OJQ-të për aktivitete:

Toka, <http://www.toka-ks.org/>

Qendra Rekreative Gërmia

Qendra për Orientim në Karrierë (Helvetas)